



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
NJËSIA E PROKURIMIT

Data 06/12/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shpenzime printimi dhe mirëmbajtje pajisjesh, (me lote)
Loti I: Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave (kompjuterat, pajisje rrjeti, pajisje elektronike zyre, etj)
Loti II: Shpenzime për printim

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Loti I: 50312600-1 Mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve të teknologjisë së informacionit.
Loti II: 79800000-2 Printime dhe shërbime të lidhura me to.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,016,983.33 (dymilion e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pike tre) lekë pa TVSH.

Loti I: Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave (kompjuterat, pajisje rrjeti, pajisje elektronike zyre, etj) me fond limit : 416,650 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh

Loti II: Shpenzime për printim, me fond limit: 1,600,333.33 (një milion e gjashtëqind mijë e treqind e tridhjetë e tremijë pike tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti I: Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave (kompjuterat, pajisje rrjeti, pajisje elektronike zyre, etj).

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është **8333 (tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre)**, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e tregëtimit të karburanteve, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit “Procedure e Hapur e thjeshtuar– Shwrbime” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, dhe Kreu II “Kufijtë monetarë” të VKM nr. 291, datë

15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000

000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Kapaciteti teknik

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: 83 330 (tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë)lekë pa Tvsh .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4,germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlloritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë nëpërmjet të cilës merr përsipër realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës” Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët deklarojnë se marrin përsipër realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Loti II: 79800000-2 Printime dhe shërbime të lidhura me to.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është

32.006,67 (tridhjetë e dymijë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse ose pagese e kryer në numrin e llogaritës së Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenin 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e tregëtimit të karburanteve, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar– Shërbime" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000

000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. *Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:*

a) *Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;*

b) *Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.*

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e

qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: 320 066,66 (treqind e njëzetmijë e gjashtëdhjetëe gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë)lekë pa Tvsh .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4,germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues për pajisjen që posedon dhe do vërë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor, duhet të paraqesë katalogun/et ose broshurë për këto pajisje. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo pajisje me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. (ne te gjitha rastet katalogu duhet i përkthyer në gjuhën shqip).

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në mbështetje të nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve ose broshurave të paisjeve që posedon operatori ekonomik dhe do ti vërë në dispozicion për realizimin e shërbimit i shërben Autoritetit Kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e produktit/eve dhe

specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesmarrës me produktin/tet dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Pra qëllimi i këtij kriteri është vërtetimi nga ana e operatorit ekonomik se paisja që do të ofrohet për realizimin e shërbimit i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor duke bërë krahasimin ndërmjet tyre.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në staf paktën 1 (një) punonjës që disponon certifikatë trajnimi për mirëmbajtjen e paisjeve nga prodhuesi i pajisjeve ose certifikata/deshmi të formimit profesional ose ekuivalentet e tyre të lëshuara nga autoritete të autorizuar /certifikuara për dhënien e tyre. Për punonjësën duhet të paraqitet dokumentacion provues si më poshtë:

- Kontratë pune e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.
- Formularët E- SIG për periudhën Tetor 2024.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1 dhe 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, kërkohet, citojmë: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) **aftësinë teknike dhe profesionale.**

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe **aftësitë teknike e profesionale** për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Gjithashtu kriteri wshtw vendosur nw mbwshtetje tw pikws 4 (b), tw nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar,ku specifikisht pwrcautohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose***

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është minimal dhe lejon konkurrimin e hapur për të gjithë operatorët ekonomi të interesuar, duke marrë në konsideratë natyrën, kohëzgjatjen e shërbimit, shtrirjen e tij në territor dhe për faktin se ky shërbim do të kryhet për të paktën 16 pajisje.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktor merr në konsideratë, që shërbimi i kërkuar në objekt prokurimi të jetë cilësor dhe i pandërprerë dhe për të arritur një shërbim të tillë, operatori ekonomik duhet të ketë stafi teknik, i cili të jetë trajnuar dhe të jetë në gjendje të ndërveprojnë në kohë për riparim/ndërrim të pjesëve të dëmtuara dhe të parandaloj defektet potenciale.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë nëpërmjet të cilës merr përsipër transportin, montimin, instalimin, konfigurimin, e pajisjeve.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës” Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët deklarojnë se marrin përsipër transportin, instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve që do të vihen në dispozicion të Autoritetit Kontraktor për realizimin e shërbimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike dhe termat e referencës për procedurën respektive janë hartuar nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike, termat e referencës dhe përlllogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.549 me nr.1350/1 prot, datë 23.05.2024, pjesë përbërëse e strukturës së Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet Teknike dhe termat e referencës janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Loti I: Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave (kompjutera, pajisje rrjeti, pajisje elektronike zyre, etj)

- a) Shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit të brendshëm të internetit do të kryhet përgjatë gjithë kohës së zgjatjes së kontratës në mjediset e zyrave administrative dhe Pallatit të Lojërave me dorë “Fetih Borova”, konsiston në zvendësim deri në 10 (dhjetë) switch 8 portësh të pamënaxhueshëm dhe zvendësim deri në 2500 ml kabëll rrjeti dhe furnizim deri në 50 (total) patch cord të gatshme rrjeti me gjatësi 2m, 5m, 10m dhe 15m.
- b) Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve Desktop 1 dhe 2 konsiston në kryerjen e të gjitha shërbimeve si formatim, resetim fjalëkalimi sistem operimi, zvendësim kartë rrjeti, zvendësim kartë grafike, shtim RAM, instalim antivirus të licensuar.
- c) Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të cilat kërkojnë furnizim dhe vendosje të pjesëve përbërëse do të kryhet në mjediset e AK-së, në rast pamundësie të kryerjes së shërbimit në mjediset e AK-së, shërbimi mund të kryehet në mjediset e OE, ku transporti do të kryehet me burimet dhe mjetet e OE-së.
- d) Pjesët për F.V duhet të jenë orgjinale (të prodhuesit ose ekuivalente), të reja, të ambalazuara dhe të padëmtuara.

Loti II Shpenzime për printim

Për të realizuar sistemin e menaxhimit të shërbimit të printimit/fotokopjimit/skanimit kërkohen pajisje me specifikimet të pasqyruara në specifikimet teknike:

- 10 pajisje printer/fotokopje/skaner A4 me ngjyra – 30-40 faq/min
- 4 pajisje printer/fotokopje/skaner A3 bardh/zi – 30-40 faq/min
- 2 pajisje printer/fotokopje/skaner A3 me ngjyra – 30-40 faq/min

Gjithashtu AK do të përdor 3 pajisje që janë në inventarin e saj konkretisht 1 pajisje Xerox AltaLink B8155 dhe 2 pajisje Xerox VersaLink C7100 për të cilat do të kryhet shërbimi i mirëmbajtjes me fuser dhe drum që në fillim.

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR PAJISJET

10 (dhjetë) pajisje me ngjyra-A4 me këto specifikime teknike

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/me ngjyra
Shpejtësia:	30 - 40faqe/min
Ekrani jo më i vogël se:	6 -10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H, jo më i madh se:	500x570x510
Kapaciteti mbajtës i sirtareve	Jo më i vogël 250faqe
Kapaciteti në dalje	Jo më i vogël 200faqe
Madhësia e letrës	A4
Memorja jo më e vogël:	2 GB
HDD - Hardisk jo më i vogël	250-320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet të mundësoj instalimin e aplikacioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe aplikacion për monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundësi skanimi në HDD	Pajisja duhet të mundësoj skanimin në HDD e saj dhe krijimin e folderave të ndryshëm për secilin përdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njëhershëm të dy anëve të letrës)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB)
Kapaciteti i SPDF/DADF (me e madhe baraz)	50 faqe
Mobile printing (aftësi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud

	Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet të mundësoj encryptimin të hardiskut për ruajtjen e informacionit të printim/skanim/fotokopjim.
Printimin në të dyja anët (Duplex)	Po
Pajisja të mundësoj skanimin e dokumentave direkt në Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

4 (katër) pajisje –A3 me këto specifikime teknike

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtësia:	30-40 faqe/min
Ekrani jo më i vogël se:	6-10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H, jo më i madh se:	450x550x700
Kapaciteti mbajtës i sirtareve	Jo më i vogël 500faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo më e vogël 250faqe
Madhësia e letrës	A6-A3
Memorja jo më e vogël:	2 GB
HDD - Hardisk jo më i vogël	250-320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet të mundësoj instalimin e aplikacioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe aplikacion për monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundësi skanimi në HDD	Pajisja duhet të mundësoj skanimin në HDD e saj dhe krijimin e folderave të ndryshëm për secilin përdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njëhershëm të dy anëve të letrës)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB)
Kapaciteti i SPDF/DADF (me e madhe baraz)	50 faqe

Mobile printing (aftësi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet të mundësoj encryptimin të hardiskut për ruajtjen e informacionit të printim/skanim/fotokopjim.
Printimin në të dyja anët (Duplex)	Po
Pajisja të mundësoj skanimin e dokumentave direkt në Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

2 (dy) pajisje –A3 me këto specifikime teknike

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Me ngjyra
Shpejtësia:	30-40 faqe/min
Ekrani jo më i vogël se:	6-10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H, jo më i madh se:	590x685x965
Kapaciteti mbajtës i sirtareve	Jo më i vogël 500faqe
Kapaciteti në dalje	Jo më e vogël 250faqe
Madhësia e letrës	A6-A3
Memorja jo më e vogël:	2 GB
HDD - Hardisk jo më i vogël	250-320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet të mundësoj instalimin e aplikacioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe aplikacion për monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundësi skanimi në HDD	Pajisja duhet të mundësoj skanimin në HDD e saj dhe krijimin e folderave të ndryshëm për secilin përdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njëhershëm të dy anëve të letrës)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB)
Kapaciteti i SPDF/DADF (me e madhe baraz)	50 faqe

Mobile printing(aftësi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet të mundësoj encryptimin të hardiskut për ruajtjen e informacionit të printim/skanim/fotokopjim.
Printimin në të dyja anët (Duplex)	Po
Pajisja të mundësoj skanimin e dokumentave direkt në Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

Totali i parashikimit të kopjeve të printuara deri:

Emërtimi	Njësia	Sasia	Periudha
Printime/fotokopjime/skanime bardh&zi A4	Fletë	200,000	12 muaj
Printime/fotokopjime/skanime me ngjyra A4	Fletë	65,000	12 muaj
Printime/fotokopjime/skanime bardh&zi A3	Fletë	10,000	12 muaj
Printime/fotokopjime/skanime bardh&zi A4	Flete	10,000	12 muaj

Sasia e pajisjeve që do të përdoren në këtë procedurë :

- 10 pajisje printer/fotokopje/skaner A4 me ngjyra – 30-40 faq/min
- 4 pajisje printer/fotokopje/skaner A3 bardh/zi – 30-40 faq/min
- 2 pajisje printer/fotokopje/skaner A3 me ngjyra – 30-40 faq/min

Gjithashtu AK do të përdor 3 pajisje që janë në inventarin e saj konkretisht 1 pajisje Xerox AltaLink B8155 dhe 2 pajisje Xerox VersaLink C7100 për të cilat do të kryhet shërbimi i mirëmbajtjes me fuser dhe drum që në fillim.

Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të tjera do të kryehet sipas sasisë së kërkuar për 12 muaj.

Afatet e lëvrimeve të pajisjeve për shërbimin e printimit, 7 (shtatë) ditë nga lidhja e kontratës së Shërbimit. Afati i realizimit të shërbimit 12 muaj nga data e lidhjes së Marrëveshjes kuadër.

Shënim: Në bazë të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.